
STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"PERFECT TASTE" SH.P.K

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“PERFECT TASTE” SH.P.K

NENI 1

THEMELIMI DHE EMRI

- 11.1 Sot me 06.10.2023 themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar Perfect Taste Shpk (ketu e me poshte referuar si "Shoqeria") ne zbatim te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "*Per tregtaret dhe shoqerite tregtare*", i ndryshuar.
- 11.2 Shoqeria fiton personalitet juridik ne momentin e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar shqiptar prane Qendres Kombetare te Biznesit ne Tirane, Shqiperi

NENI 2

SELIA

- 2.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Autostrada Tiranë – Durrës, Km. 7, Kashar, Tiranë, Qendra Tregtare Univers” Sh.p.k.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

- 3.1 Qellimi i Shoqerise eshte zhvillimi i çdo aktiviteti biznesi dhe/ose aktiviteti te ligjshem qe mund te ushtrohet nga nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas ligjeve te Shqiperise, siç mund te ndryshohen here pas here.
- 3.2 Ne veçanti, objekti i shoqerise perfshin Sherbime restoranti, linje restorantesh, linje sherbimi ushqimi te shpejte. Sherbim Hotelerie, Kafe -Bar, Supermarkete, Minimarkete, Tregtim me shumice dhe pakice te produkteve ushqimore. Import, eksport, tregtimi me shumice dhe pakice i produkteve te ndryshme.

NENI 4

KOHEZGJATJA

1. Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete e pakufizuar.



NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

- 5.1 Kapitali fillestar i Shoqerise eshte 100 leke (njqind), qe konsiston ne 1 kuote me vleren 100 Leke.
- 5.2 Kapitali themeltar eshte paguar plotesisht nga Ortaku i Vetem, shoqeria BIZ HOLDING GROUP SHPK qe zoteron 100% te kapitalit te Shoqerise.
- 5.3 Kuotat jane te transferueshme dhe mund te transferohen ne çdo kohe sipas ligjit shqiptar.
- 5.4 Pergjegjesia e Ortakut te Vetem shtrihet deri ne Shumen e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise

NENI 6

ORTAKU I VETEM

- 6.1 Ortaku i Vetem i Shoqerise eshte BIZ HOLDING GROUP SHPK, nje shoqeri e regjistruar prane Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L62203019G, me seli ne adresen Rruga Onhezmi, pallati 26, apartamenti 39, Sarandë, Shqiperi, perfaqesuar rregullisht nga Anamari Hasula, administrator.
- 6.2 Ortaku i Vetem ne perputhje me legjislacionin shqiptar mund te marre, por pa u kufizuar ne to, çdo vendim ne lidhje me sa me poshte vijon:
 - percaktimin e politikave tregtare dhe investimeve; -ndryshimin e ketij statuti; -miratimin e bashkimit me shoqeri te tjera; -zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit; -emerimin dhe shkarkimin e administratorit/eve; -emerimin e ekspertit/eve kontabel te autorizuar; -percaktimin e shperblimeve te administratorit/eve, likuiduesit/eve dhe ekspertit/eve kontabel te autorizuar;
 - mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administrator/et, perfshire mbikqyrjen e pergatitjes se pasqyrave financiare dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - miratimin e raportit te administratorit/eve dhe pasqyrat financiare; -shperndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
 - ri-organizimin dhe prishjen e Shoqerise;
 - mbylljen e Shoqerise dhe emerimin e likuiduesit/eve;
 - çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji ose statuti.
- 6.3 Te gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetem do te regjistrohen ne Regjistrin e Vendimeve te Ortakut te Vetem, te dhenat e te cilit nuk do te mund te ndryshohen apo fshihen.
- 6.4 Çdo vendim i cili nuk do regjistrohet ne Regjistrin e Vendimeve te Ortakut te Vetem eshte i pavlefshem. Kjo nuk do te ndikojë ne pergjegjesine e Shoqerise ndaj paleve te treta perveç rasteve kur Shoqeria do te vertetoje se pala e treta kishte dijeni per parrëgullsine apo ne baze te rrethanave nuk mund te mos kishte patur dijeni.
- 6.5 Çdo vendim i Ortakut te Vetem mund te merret jashte territorit te Republikes se Shqiperise dhe nje evidence me shkrim per çdo vendim te marre jashte do ti dergohet administratorit, i cili duhet ta regjistroje ate ne Regjistrin e Vendimeve te Ortakut te Vetem.



NENI 7


ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 7.1 Pasurite, biznesi dhe veprimtaria e Shoqërisë administrohet nga 1 Administrator, të cilët janë të autorizuar të veprojnë veçmas, përveç nëse parashikohet ndryshe në vendimin e emerimit të tyre nga Ortaku i Vetem.
- 7.2 Me përjashtim të rastit kur vendimi i Ortakut të Vetem për emerimin e administratorit parashikon ndryshe, Administratori/et ka/ne të gjitha kompetencat siç janë të përcaktuara në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë por pa kufizuar në sa më poshtë vijon:
- administrimin dhe drejtimin e operacioneve të Shoqërisë në Shqipëri si dhe kryerjen e çdo veprimi që mund të jetë i nevojshëm për drejtimin e aktivitetit të Shoqërisë;
 - perfaqësimin e Shoqërisë ndaj të gjitha enteve publike dhe/ose private, enteve ose autoriteteve shqiptare dhe/ose të huaja;
 - nenshkrimin, hartimin, zbatimin e çdo dokumenti përfshirë dokumentet financiare, hapjen dhe/ose mbylljen e llogarive bankare në emër të Shoqërisë, si dhe veprime të lidhura;
 - punësimin dhe shkarkimin e personelit brenda politikave të vendosura nga Shoqëria;
 - kryerjen e çdo akti tjetër të zakonshëm dhe jashtëzakonshëm administrativ për administrimin e Shoqërisë;
 - ekzekutimin e akteve ligjore në emër të Shoqërisë në lidhje me aktivitetin e saj;
 - nenshkrimin dhe kryerjen e të gjitha akteve dhe çështjeve të tilla për një administrim efikas të Shoqërisë në Shqipëri
- 7.3 Administratori i Shoqërisë mund të transferojë të një person apo grup personash të gjitha apo një pjesë të kompetencave sipas këtij Statuti me kushtet, të cilat konsiderohen të arsyeshme dhe ky transferim kompetencash mund të anulohet në çdo kohë.
- 7.4 Shkarkimi ose zëvendësimi i Administratorit bëhet nëpërmjet një vendimit të Ortakut të Vetem. Ky shkarkim ose zëvendësim nuk konsiderohet si ndryshim i Statutit dhe vendimi përkatës i Ortakut të Vetem nuk është i nevojshëm të pasqyrohet në Statut.
- 7.5 Administratori i parë i Shoqërisë është: Dhimitër Caka, shtetas shqiptar, lindur më 12.08.1976, mbajtes i letërnjoftimit me nr. 038222363 dhe nr.personal H60812094I.
- 7.6 Administratori i Shoqërisë ushtron kompetencat respektive për një afat 5 vjeçar.

NENI 8

EKSPERTI KONTABEL

- 8.1 Eksperti/et kontabel të autorizuar emërohen me vendim të Ortakut të Vetem në çdo rast kur është e detyrueshme nga legjislacioni shqiptarose kur Ortaku i Vetem e konsideron të nevojshme.



NENI 9

VITI FINANCIAR

9.1 Viti financiar i Shoqerise do te jete nga 1 Janar deri ne 31 Dhjetor.

9.2 Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon me daten e regjistrimit te Shoqerise dhe perfundon me 31 Dhjetor te te njejtit vit.

NENI 10

LIKUIDIMI

10.1 Likuidimi dhe emerimi i likuiduesit/ve, do te behet sipas ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe ligjeve te tjera te zbatueshme.

NENI 11

LIGJI I ZBATUESHEM

11.1 Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me Statutin dhe dispozitat e ligjit Shqiptar

11.2 Ligj nr. 9901, date 14.04.2008 "Per treglaret dhe shoqerite regtare ", i ndryshuar, do te zbatohet ne lidhje me sa nuk parashikohet nga Statuti.

11.3 Çdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin ose interpretimin te ketij Statuti do te zgjidhet nga gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane

NENI 12

TE NDRYSHME

12.1 Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet ose shfuqizohet, ose te zevendesohet me nje statut te ri me Vendim te Ortakut te Vetem.

Ky Statut u hartua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe. Pasi u lexua nga ortaku themelues i Shoqerise PERFECT TASTE SH.P.K, ky akt u nenshkrua pa verejtje.

ORTAKU I VETEM

BIZ HOLDING GROUP SHPK

